



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDARYSHE**

*5 shtator 2018, Prizren*

**KOMUNIKATË  
Publikohet Propozim Karta e Qytetit të Prizrenit**

EC Ma Ndryshe ka hartuar një propozim të Kartës së Qytetit të Prizrenit, i cili do t'i prezantohet autoriteteve komunale për shqyrtim dhe miratim e zbatim.

Karta e Qytetit si akt ka për qëllim që të promovojë dhe fuqizojë të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit, në kuadër të menaxhimit të përgjithshëm të qytetit. Ajo parashihet që të zbatohet në raport me të gjithë qytetarët, pa diskriminim, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të Komunës së Prizrenit. Njëkohësisht zbatimi i të drejtave të përshkruara në këtë Kartë paraqet vetëm një instrument plotësues dhe përforcues për të drejtat ekzistuese në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Prandaj ky akt më shumë ka kuptimin e një deklaratë të parimeve, që shërben si mjet për reformimin urban, duke përqafuar praktikën e qeverisjes së mirë dhe të gjithëpërfshirjes, si dhe aktivizmin qytetar. Pas dispozitave për të drejtat mbi qytetin e Prizrenit, propozimi në fjalë përmban edhe mekanizmat e zbatimit të Kartës së Qytetit.

Njohja e rolit të qyteteve si akterë kryesorë në garantimin e të drejtave të njeriut si ofrues të shërbimeve publike dhe si institucione përgjegjëse për arsimin, shëndetësinë primare e politikën e strehimit social ka fituar peshë pas viteve të 90'ta. Ndërsa karta të ndryshme lokale të të drejtave janë miratuar nga viti 2000 e tutje. Madje ka karta të kësaj natyre që janë të nënshkruara nga qindra qytete, si p.sh. Karta Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Qytet ([https://www.uclg-cisd.org/sites/default/files/CISDP%20Carta-Agenda\\_ENG\\_0.pdf](https://www.uclg-cisd.org/sites/default/files/CISDP%20Carta-Agenda_ENG_0.pdf)).

Mbi këtë bazë edhe është ndërmarrë nisma ambicioze për hartimin e Kartës së Qytetit të Prizrenit. Hartimit të kësaj karte i ka paraparur procesi i konsultimit disa javor me grupet e nën-përfaqësuar të qytetit, si: komuniteti i të rinjve, grave, të moshuarve, Personave me Aftësi të Kufizuara, komuniteti i kulturës, sikurse edhe diskutimi me zyrtarët komunalë të dikastereve të ndryshme. Një grup aktivistësh është angazhuar në mbledhjen e nënshkrimeve që kanë për qëllim fuqizimin e miratimit të Kartës së Qytetit nga autoritetet lokale. Pika mbledhëse e nënshkrimeve do të jetë e hapur për qytetarë edhe në Sheshin Shadërvan, duke filluar nga sot deri të Premtën, datë 27.09.2018.

Propozim Karta e Qytetit të Prizrenit do t'i prezantohet autoriteteve të pushtetit lokal të Prizrenit, me kërkesën që i njëjti të shqyrtohet dhe miratohet nga organet vendimmarëse komunale dhe më pastaj të zbatohet nga dikasteret e Ekzekutivit lokal.

Për detajet më të hollësishme këtu gjeni publikimin Karta e Qytetit "E Drejta mbi Qytetin e Prizrenit": [http://ecmandryshe.org/repository/docs/180905085117\\_KARTA\\_E\\_QYTETIT.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/180905085117_KARTA_E_QYTETIT.pdf)

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

+381 38 224 967 & +381 29 222 771